



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

Nr. Prot. 19/189

Datë 29.12.2023

Lënda: Informacion për rastet e sinjalizuara pranë njësisë përgjegjëse për vitin 2023

Drejtuar: **INSPEKTORIATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT  
TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE**  
Tiranë

Në zbatim të Ligjit nr.160/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, Ju bëjmë me dije se për vitin 2023 nuk ka patur asnjë rast të sinjalizuar pranë Njësisë Përgjegjëse në MEPJ, si dhe nuk ka pasur ndryshime në këtë strukturë.

Gjithashtu në zbatim të këtij Ligji, Njësia Përgjegjëse në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme ka hartuar rregulloret si më poshtë :

1. Rregullore për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në MEPJ.
2. Rregullore për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në MEPJ.

Rregulloret janë miratuar nga Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme duke nxjerrë aktet administrative përkatëse.

Në vitin 2023 DAB ka organizuar një sesion trainimi me punonjës të MEPJ kryesisht diplomatë të rinj, me tematikë “Fusha audituese dhe ndërveprimi në institucion”. Në këtë sesion trainimi u trajtuan tema që lidhen me shërbimin e auditimit, gjithashtu u trajtua edhe tema mbi “Ligjin për sinjalizimin” dhe rregulloret e MEPJ.